

2. ZHVILLIMET KRYESORE DHE PRIORITETET

Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit, këtë vit, midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore Evropiane (BQE) për fushën e mbikëqyrjes bankare, i përcaktuar si një zhvillim me rëndësi në prioritetet e vitit të kaluar, i jep mundësinë Bankës së Shqipërisë të vendosë një marrëdhënie bashkëpunimi më të strukturuar dhe formalizuar me institucionin më të rëndësishëm financiar të Bashkimit Evropian (BE). Ai përcakton mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellë midis dy institucioneve, duke parashikuar shkëmbimin e informacioneve dhe kryerjen e një mbikëqyrjeje efektive.

Në kuadër të bashkëpunimit me autoritetet homologe, kemi marrë pjesë në tre kolegje mbikëqyrëse të organizuara për grupet bankare evropiane të pranishme edhe në Shqipëri. Edhe pse Banka e Shqipërisë merr pjesë me statusin e vëzhguesit në kolegji, vlerësimet e ngritura për aktivitetin e filialeve në Shqipëri janë konsideruar dhe përcjellë në menaxhimin e rreziqeve në nivel grupi. Gjithashtu, gjatë vitit 2018, ka pasur një fluks të rregullt informacioni mbi vlerësimin e planit të rimëkëmbjes së grupit, si dhe përcaktimit të kërkesave për kapital. Në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve mbikëqyrëse, edhe këtë vit, u zhvillua një ekzaminim i përbashkët (i targetuar) me mbikëqyrësit e BQE-së në një nga bankat me origjinë nga BE-ja.

Të evidentuara si tendenca të pritshme që do të monitorohen me kujdes, gjatë vitit 2018, pati **disa zhvillime strukturore të pronësisë në sistemin bankar**, që lidhen me **konsolidimin e strukturës** së pjesëmarrësve në tregun bankar, duke e çuar numrin e bankave në sistem në 14 dhe potencialisht në 12, me materializimin e përthithjes tashmë në proces finalizimi për një bankë dhe likuidimin vullnetar të një banke tjetër. Në këtë kontekst, kanë ndodhur apo mbeten në proces këto ngjarje:

- bashkimi me përthithje i dy bankave të sistemit. Procesi u diktua nga zhvillimet në vendin e origjinës së kapitalit të të dy bankave, më shumë sesa si një nevojë e brendshme e tregut. Për rrjedhojë, Banka Intesa Sanpaolo mori në pronësi dhe u bashkua me Bankën Veneto, pasi Banka Veneto shpalli falimentin dhe u ble nga Banka Intesa Sanpaolo në Itali;
- Banka Amerikane e Investimeve mori pronësinë dhe u bashkua me Bankën NBG, Shqipëri. Kjo ngjarje u mbështet nga plani i ristrukturimit të sistemit bankar në Greqi për uljen e ekspozimit jashtë Greqisë, në kuadër të Planit të Ristrukturimit të NBG Bank, Greqi, dhe në linjë me angazhimet e saj ndaj Komisionit Evropian;
- Banka Union ka marrë pronësinë e Bankës Ndërkombëtare Tregtare. Kjo ngjarje u përcaktua nga vendimi i aksionerëve të kësaj të fundit për



t'u larguar nga tregu shqiptar, por edhe ambicieve të hershme të Bankës Union për t'u zgjeruar në tregun vendas, nëpërmjet përthithjes së një banke ekzistuese;

- Banka Tirana, ish pjesë e Grupit Pireu, për të njëjtat arsye si në rastin e Bankës NBB, përmbylli shitjen e aksioneve të saj tek Grupi Balfin sh.p.k. dhe Banka Comercijalna A.D. Shkup. Ky transaksion mori miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në muajin shkurt 2019;
- Banka Societe Generale Albania u shit tek banka OTP Bank Nyrt, me origjinë kapitali nga Hungaria, si pjesë e strategjisë së bankës mëmë për t'u tërhequr në përgjithësi nga rajoni i Ballkanit;
- së fundi, aksionerët e Bankës së Kreditit të Shqipërisë kanë vendosur likuidimin vullnetar të bankës, proces i cili pritet të finalizohet gjatë pjesës së parë të vitit 2019.

Ngjarjet e përmendura më sipër janë materializim i tendencave të shfaqura vitet e fundit për konsolidim të tregut bankar dhe pjesa më e rëndësishme e ndryshimeve të pritshme ka ndodhur. Këto ndryshime sjellin një rritje të peshës në treg të kapitalit vendas, interes ky që pritet të sjellë një rigjallërim të aktivitetit bankar, ku vëmendja mbikëqyrëse do të përqendrohet në ruajtjen e cilësisë së administrimit të rreziqeve dhe të treguesve të shëndetit financiar.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë, që identifikohet si rreziku kryesor mbi bazën e volumit dhe peshës së aktivitetit, ndikimit në pozicionin financiar të bankave dhe kërkesës dominuese për kapital, pësoi një rënie të konsiderueshme. Treguesi kryesor i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë arriti në 11,08% në fund të vitit 2018, duke u përafruar në këtë mënyrë me të njëjtën periudhë të një dekade më parë. Treguesi u ul me 2,15 pp, në kushtet kur portofoli i kredive me probleme u ul me rreth 15,2 miliardë lekë apo rreth 19%, si pasojë kryesisht e ngjarjeve që lidhen në masën më të madhe me fshirjen e kredive me probleme dhe zgjidhje të tjera të tyre.

Me gjithë uljen e vazhdueshme të rrezikut ndaj këtij ekspozimi, Banka e Shqipërisë, si pjesë të qasjes së saj për adresimin e problematikave në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, element ky i përcaktuar si një ndër prioritetet mbikëqyrëse të vitit 2018, mbetet e angazhuar të ofrojë një zgjidhje sa më të mirë dhe realizimin e plotë të të gjitha angazhimeve të saj, në kuadër të **planit kombëtar për reduktimin e kredive me probleme**. Në funksion të këtij qëllimi ka hartuar edhe një projektregullore **për adresimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve**, të cilën e ka diskutuar në disa takime me bankat gjatë vitit, si dhe nëpërmjet komunikimit shkresor. Shkëmbimi i opinionëve dhe reflektimi i tyre në draftin e rregullores ka marrë kohë nga të gjitha palët, për shkak të natyrës komplekse të ngritjes së një forme bashkëpunimi të qëndrueshëm e të rregulluar midis bankave. Ndërkohë, në takimet e organizuara me bankat, janë diskutuar edhe çështje të rëndësishme në funksion të administrimit të rrezikut të kredisë, siç janë përdorimi i pasqyrave financiare zyrtare të huamarrësve, si dhe një studim i shoqërisë Deloitte mbi qëndrueshmërinë financiare të bizneseve më të mëdha në vend, studim ky i financuar nga projekti FinSAC i Bankës Botërore.



Banka e Shqipërisë është pjesë e diskutimeve për ngritjen e **Byrosë së Kredisë**, ku marrin pjesë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB). Diskutimi midis palëve ka filluar që në vitin 2016 dhe gjatë vitit të kaluar janë organizuar disa takime, ku janë diskutuar çështjet kryesore lidhur me modelet që mund të gjejnë zbatim për ngritjen e kësaj byroje, pozicionimin institucional të saj, strukturën qeverisëse dhe mënyrën e financimit. Qëndrimi përfundimtar mbi çështjet në diskutim pritet të gjejë një qartësi më të plotë gjatë vitit 2019.

Një nga risitë mbikëqyrëse të evidentuara edhe në raportin e vitit të kaluar, në vitin 2018, bankat raportuan për herë të parë vlerësimin e brendshëm të kapitalit, në kuadër të dokumentit **“Vlerësimi i Brendshëm i Mjaftueshmërisë së Kapitalit”**. Rrjedhimisht, shqyrtimi dhe analiza konkluduese mbi këto raporte, përfshirë edhe **“Planet e Rimëkëmbjes”**, kanë qenë një sfidë e veçantë, që ka kërkuar një periudhë relativisht të gjatë kohe për shqyrtim dhe një vëmendje gjithëpërfshirëse. Këto dy dokumente përfaqësojnë një vetëvlerësim të plotë të aftësive të bankës, si për të kontrolluar dhe përballuar nivelet e rreziqeve që lindin gjatë aktivitetit të zakonshëm, ashtu edhe për t’u rimëkëmbur nga një situatë e vështirë financiare. Më konkretisht:

- vlerësimi i parë i këtij dokumenti evidentoi efektet sasiore të llogaritura nga bankat, përputhshmërinë me kërkesat rregullative, si dhe disa mangësi për një përfshirje më të gjerë e më cilësore të rreziqeve me efekte të mundshme në nevojat për kapital. Nga vlerësimi rezultoi se informacioni i përfshirë në këto dokumente nuk ishte i mjaftueshëm për Bankën e Shqipërisë për të dakordësuar një normë minimale të mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat, çka pritet të jetë edhe rezultati fundor nga ky proces. Çështjet e evidentuara iu prezantuan bankave me një komunikim të formalizuar shkresor në fillim të vitit 2019, komunikim i cili pritet të jetë i vazhdueshëm, me qëllim rritjen e cilësisë së përgatitjes së këtij dokumenti në të ardhmen;
- planet e rimëkëmbjes, gjatë vitit 2018, i janë nënshtruar kërkesave të zgjeruara rregullatore, ndërsa vlerësimi i tyre është kryer në komunikim të ngushtë me bankat dhe me asistencën e vlefshme të Bankës Botërore (BB). Hartimi i planeve nga ana e bankave ka njohur një rritje cilësore, megjithatë ka ende elemente për përmirësim dhe integrim më të plotë me kuadrin e brendshëm të menaxhimit të rreziqeve, si dhe me strategjitë dhe objektivat, në nivel individual dhe në nivel grupi.

Përmirësimi i proceseve mbikëqyrëse, një proces zhvillimi ky i përcaktuar edhe në raportet e viteve të kaluara. Dy projekte të asistuar nga BERZH-i dhe BB-ja janë në fazën e fundit të finalizimit. Më konkretisht:

- me asistencën e BERZH-it, u krye një vlerësim i procedurave të brendshme mbikëqyrëse të vlerësimin të rreziqeve, kryesisht rrezikut organizativ dhe atij të kredisë, si edhe të kuadrit rregullativ për këtë qëllim, i shoqëruar me propozime konkrete për ndryshim. Bazuar në këto vlerësime, u



hartua plani për zbatimin e tyre, përfshirë edhe trajnimin e bankave dhe punonjësve të Departamentit të Mbikëqyrjes;

- me asistencën e BB-së dhe të shoqërisë Grant Thornton, u hartua projektdokumenti i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe vlerësimit të auditorëve të jashtëm, me qëllim përmirësimin si të cilësisë së kontrollit të bankave, ashtu edhe të vetë auditorëve, por jo vetëm. Përcaktimi i një udhërrëfyese dhe përgatitja për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe raportimit përbën një tjetër objektivi të këtij projekti, i cili mbetet për t'u vlerësuar gjatë vitit 2019.

Në pjesën e parë të këtij viti, Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) **përfundoi raundin e pestë të vlerësimit të Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit**, proces i nisur dhe raportuar që në vitin 2017. Vlerësimi, ku Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol të veçantë mbështetës në pozicionin e institucionit mbikëqyrës për pjesën më të madhe të tregut financiar, u përmbyll në muajin korrik 2018, me kalimin e raportit vlerësues në seancë plenare të Moneyval-it. Sipas këtij raporti, subjektet financiare u vlerësuan në nivelin "*substantial*/i konsiderueshëm" të efektivitetit, në kushtet kur veçanërisht bankat paraqesin një njohje të mirë të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, detyrimeve ligjore, si dhe kanë marrë përgjithësisht masat e duhura në raport të drejtë me nivelin e vlerësuar të rrezikut për parandalimin e pastrimit të parave (PPP) dhe financimit të terrorizmit.

Procesi i vlerësimit u shoqërua me disa rekomandime në vijim të të cilave u hartua një plan masash, me qëllim adresimin e problematikave kryesore të evidentuara në raport. Përbushja e tyre do të vijojë përgjatë vitit 2019. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë ka hartuar planin e saj të veprimit, sipas të cilit mbetet e angazhuar që, brenda muajit maj 2019, të ketë realizuar përmirësimet e nevojshme në kuadrin rregullator dhe forcimin e efektivitetit të procesit mbikëqyrës. Gjithashtu, bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), gjatë vitit, ka vijuar në mënyrë edhe më intensive. Ky bashkëpunim u materializua në kuadër të procesit të vlerësimit të Moneyval-it, inspektimeve të përbashkëta si edhe kontributit në drejtim të rishikimit të kuadrit ligjor për çështje të parandalimit të pastrimit të parave.

Përveç sa më sipër, në përbushje të prioritetëve të vendosura për vitin 2018, Banka e Shqipërisë ka hartuar kuadrin rregullativ në përputhje me Bazel III, si dhe ka kryer edhe procesin e ekuivalencës, elemente këto për të cilat jepet një informacion më i detajuar në përmbajtje të këtij raporti.

Së fundi, në mbështetje të misionit të saj, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Departamentit të Mbikëqyrjes, ka vijuar aktivitetin normal të monitorimit të sistemit financiar – kryesisht bankave – nëpërmjet **inspektimeve në vend dhe analizave nga jashtë**, për vlerësimin e masës së ekspozimit ndaj rreziqeve individuale dhe ambientin e kontrollit për administrimin e tyre, si dhe në drejtim



të rishikimit/përmirësimit të kuadrit rregullativ dhe licencimit të subjekteve, apo veprimtarive shtesë.

2.1 EKZAMINIMET NË VEND

Gjatë vitit 2018, janë zhvilluar ekzaminime të plota dhe të pjesshme në 7 banka, në 10 subjekte financiare jobanka (SFJB) dhe në 31 zyra të këmbimit valutor (ZKV). Vëmendja dhe burimet kryesore janë përqendruar në ekzaminimet e bankave, të cilat zënë peshën kryesore në aktivitetin e tregut financiar. Në fokus të veçantë kanë qenë bankat në proces blerjeje/bashkimi, apo bankat me ritëm të lartë rritjeje. Ndërkohë, nga ekzaminimet e përmendura më lart, ato për 5 banka, 7 subjekte financiare jobanka dhe për 8 zyra të këmbimit valutor, janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, ndërsa në një bankë është kryer në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.


Tabelë 1. Numri i ekzaminimeve sipas viteve dhe sipas tematikës

Inspektime të kryera në subjekte	Rreziku Strategjik	Rreziku Organizativ	Rreziku i Kredisë	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Normës së Interesit	Rreziku i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit	Rreziku Operacional	Rreziku Reputacional	Përfutshmëria	Kapitali
2016*	6	7	8	6	7	7	7	7	8	6	8
2017	9	12	13	10	10	9	11	8	11	10	11
2018	8	10	9	8	8	8	9	8	48	9	8

* Në vitin 2016 janë kryer edhe 14 inspektime të përbashkëta me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave (ASD) në shoqëri të kursim-kreditit. Prania e Bankës së Shqipërisë ka qenë në mbështetje të ASD-së.

Fushat kryesore në të cilat janë përqendruar rekomandimet e ekzaminimeve të kryera gjatë vitit 2018, mund të përmbliidhen si më poshtë:

- rritja e rolit të Këshillit Drejtues në hartimin e planeve strategjike (përfshirë planifikimin e nevojave për kapital), si dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;
- sigurimi i raportit të duhur mes anëtarëve të varur dhe të pavarur të Këshillit Drejtues;
- përshtatja dhe plotësimi i strukturës organizative, në përputhje me ritmet e rritjes së aktivitetit, si dhe sigurimi i sistemeve të përshtatshme të motivimit dhe shpërblimit;
- forcimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, rritja e cilësisë së punës dhe pavarësisë së strukturave të kontrollit;
- zbatimi i kujdesshëm i politikave të investimeve, duke shmangur instrumentet komplekse, të cilat nuk kanë renditje të njohur;
- trajtimi i kujdesshëm i grupeve të kredimarrësve të lidhur, si dhe forcimi



i kritereve të pranueshmërisë gjatë analizave financiare të kredive. Riklasifikimi i kredimarrësve dhe krijimi i fondeve rezervë shtesë;

- thellimi i analizave lidhur me rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e normave të interesit;
- rritja e mbështetjes nga TIK, forcimi i programit të sigurisë, vlerësimi i rregullt i rreziqeve, rishikimi i planit të vazhdimësisë së punës, shtimi i stafit etj.;
- zbatimi i saktë i kërkesave rregullatore për llogaritjen e treguesve të kapitalit;
- rritja e vëmendjes në drejtim të masave për PPP-në, aplikimi i sistemeve të automatizuara të kontrollit, trajnimi i stafit etj.

Bankat, në përgjithësi, kanë reaguar në kohën e duhur ndaj rekomandimeve, duke marrë masat përkatëse për të siguruar në çdo kohë përputhshmërinë me kërkesat rregullatore.

Subjektet financiare jobanka. Vëmendja gjatë vitit 2018 është përqendruar tek subjektet që janë pjesë e grupeve bankare, në funksion të vlerësimit të këtyre grupeve në mënyrë gjithëpërfshirëse. Rezultatet në përgjithësi kanë qenë pozitive, duke evidentuar një menaxhim të kujdesshëm të rreziqeve përmes të gjithë grupit, në përputhje me kufizimet rregullatore për palët e lidhura. Në fokusin mbikëqyrës, gjatë këtij viti, kanë qenë edhe subjektet e mikrokredisë dhe ato që ofrojnë shërbime të pagesave. Çështjet e evidentuara gjatë ekzaminimeve lidhen me riklasifikimin e portofolit të kredive dhe efektet përkatëse në pasqyrat financiare, menaxhimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore, përmirësimin e kuadrit të brendshëm të qeverisjes, sistemeve të kontrollit të brendshëm etj. Procesi mbikëqyrës në vend për këto subjekte është fokusuar edhe në vlerësimin e nivelit të transparencës me klientët, ku është konstatuar se subjektet me eksperiencë të konsoliduar në treg përgjithësisht paraqesin një nivel më të lartë transparence dhe vëmendjeje ndaj ankesave të klientëve. Ndërsa subjektet më të reja, edhe pse janë kujdesur për respektimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore, kanë hapësira për të përmirësuar në nivelin e transparencës. Në përfundim të ekzaminimeve janë lënë rekomandime për përmirësimet e nevojshme.

Pjesë e procesit mbikëqyrës është edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, si dhe reagimi i shpejtë në rastet e identifikimit të rreziqeve potenciale apo thyerjeve të treguesve të raportuar nga subjektet banka dhe jobanka. Edhe gjatë vitit 2018, krahas ekzaminimeve në vend, ka pasur korrespondenca e kontakte të shpeshta me të gjitha subjektet, në përgjigje të ngjarjeve apo zhvillimeve me potencial për të ndikuar në gjendjen financiare të tyre, shoqëruar me masa dhe kërkesa specifike mbikëqyrëse. Banka e Shqipërisë ka qenë e vëmendshme edhe ndaj zhvillimeve ndërkombëtare, si në rastin e krizës së Turqisë, duke ndërmarrë masa kufizuese e parandaluese për bankat me ekspozime në këtë vend.



2.2 PRIORITETET PËR VITIN 2019

Zhvillimet e vitit 2018 në **konsolidimin e bankave** ndryshuan panoramën e aktorëve të tregut, duke paralajmëruar risi në zhvillimet bankare. Gjatë vitit në vijim, siç janë përmendur më lart, priten ndryshime të tjera në aksionerët e bankave. Në këtë fazë të ecurisë do t'i kushtohet vëmendje procesit të miratimit të ndryshimeve të njoftuara, si dhe monitorimit të kryerjes së mbikëqyrjes së tyre nga afër, në drejtim të vlerësimit të strategjive zhvillimore, zbatimit të tyre dhe rishikimit të strategjive të administrimit të rreziqeve e proceseve të brendshme, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me pritshmëritë rregulatore e mbikëqyrëse.

Me gjithë rënien e vazhdueshme të nivelit të **kredive me probleme**, ky rrezik mbetet në vëmendje qendrore të mbikëqyrjes. Masat e marra nga Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me autoritete të tjera qeveritare, kanë dhënë ndikim të mjaftueshëm për zbutjen e këtij fenomeni. Bankat gjithashtu kanë qenë aktive për zgjidhjen individuale të kredimarrësve, por niveli aktual vijon të mbetet i lartë. Mbikëqyrjes së planeve të bankave për uljen e kredive me probleme, përkrah monitorimit të proceseve të menaxhimit të rreziqeve, vitin në vijim, do t'i shtohet edhe hyrja në fuqi e kuadrit rregullativ për trajtimin e huamarrësve të përbashkët në vështirësi financiare. Kjo platformë bashkëpunimi pritet të sjellë një frymë të re të unifikuar të trajtimit të huamarrësve dhe të përmirësojë efektivitetin e zgjidhjeve.

Raporti i Përputhshmërisë (Screening Report) me *Acquis Communautaire*, është një nga zhvillimet kombëtare me një përfshirje të gjerë institucionale, mbi bazën e të cilit Komisioni Evropian për Shqipërinë do të vlerësojë nëse ekzistojnë kapacitetet për të nisur negociatat për kapitujt përkatës të Raport Progresit. Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për vlerësimin e disa prej kapitujve të këtij raporti dhe, në bazë të rezultatit të raportit, do të rishikojë përafrimin e akteve rregullative që lidhen me veprimtarinë e institucioneve të kreditit (bankave), por jo vetëm.

Përafrimi i kuadrit rregullativ mbetet një proces i vazhdueshëm, si për shkak të nevojës dhe objektivave për të arritur standardet më të mira, ashtu dhe për shkak të ndryshueshmërisë së vazhdueshme të akteve referuese evropiane. Përafrimi me Bazel III do të jetë një nga risitë e vitit në vijim, me vëmendjen të fokusuar kryesisht tek aktet rregullative që lidhen me treguesit e likuiditetit, ekspozimet e mëdha dhe provat e rezistencës që duhet të kryhen nga bankat.

Plotësimi i **rekomandimeve të Komitetit Moneyval** do të shtrihet si për pjesën teknike (përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator), ashtu edhe për pjesën e efektivitetit që lidhet me një numër çështjesh në fushën e zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe të bashkëpunimit ndërinstitutional. Në këtë kuadër, si dhe të planit të veprimit kombëtar për zbatimin e rekomandimeve të Moneyval, në detyrat e Bankës së Shqipërisë - përveç atyre që lindin për të



gjitha institucionet që sipas ligjit kanë një rol specifik - parashihen një numër i konsiderueshëm aktiviteteve përkushtuar vetëm vlerësimit në vend të kuadrit qeverisës të institucioneve financiare dhe efektivitetit të tyre. Aktivitetet synohet të kryhen kryesisht në bashkëpunim me DPPP-në, duke maksimizuar sinergjitë dhe efektivitetin, por edhe në mënyrë të pavarur.

Procesi i Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës do të rishihet në dritën e ndryshimeve rregullative dhe prezantimit për herë të parë nga bankat, në vitin 2018, të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit. Ky përbën edhe një nga referencat më të rëndësishme të mbikëqyrjes, siç është përcaktuar edhe nga Komiteti i Bazelit, dhe puna gjatë këtij viti do të konsistojë në rritjen e cilësisë së vlerësimit të tyre për t'i dhënë vëmendjen e duhur të gjitha rreziqeve ndaj të cilave ekspozohen bankat. Ndërkohë, do të rishihen në një dritë të re edhe planet e rimëkëmbjes, kur pritet të përgatiten duke iu referuar pikërisht dokumentit të vlerësimit të kapitalit nga ana e bankave. Për këtë proces dhe ato të përmendura më lart, do të mbështetemi edhe në asistencën e Fondit Monetar Ndërkombëtar për një zbatim sa më të plotë të praktikave ndërkombëtare.

Gjatë vitit, do të përmbyllet procesi i rishikimit të manualit mbikëqyrës, duke e përditësuar me çështjet e **qeverisjes së korporatave**, në vijim të projektit të mbështetur nga BERZH-i dhe me asistencën e kompanisë Deloitte. Këto rishikime të manualit të vlerësimit të rreziqeve parashikojnë një shqyrtim më të thelluar të çështjeve të qeverisjes së korporatave në banka dhe rrjedhimisht një vlerësim më të plotë të tyre. Po kështu, do të rishqyrtohen edhe të gjitha aktet rregullative që preken nga këto ndryshime.

Në përfundim të një projekti të mbështetur nga Banka Botërore dhe me asistencën e kompanisë Grant Thornton, procesi mbikëqyrës do të pasurohet edhe me një dokument të brendshëm, i cili do të udhëzojë në mënyrë metodike **procesin e komunikimit midis mbikëqyrësve dhe auditorëve**. Ky proces krijon mundësitë për përmirësimin dhe rritjen e nivelit të kontrollit të bankave, duke përfshirë në shkallë më të gjerë auditorët e jashtëm, në funksion të interesave mbikëqyrëse.

